

## REZULTATE NGA HULUMTIMI

### "PËRDORIMI I SUBSTANCAVE PSIKOAKTIVE TEK POPULLATANË REPUBLIKËN E MAQEDONISË"

Projekti shkencor-hulumtues "Hulumtim për përdorimin e substancave psikoaktive tek popullata në Republikën e Maqedonisë" që u realizua në vitin 2017 nga Instituti i shëndetit publik i Republikës së Maqedonisë kishte për qëllim të grumbullojë të dhëna për prevalencën e përdorimit të llojeve të ndryshme të substancave nga popullata e gjerë, si dhe nga nëngrupe relevante të popullatës. Është me rëndësi të theksohet se rezultatet janë fituar nga një grup i synuar që në këtë hulumtim i përfshin të gjithë banorët në Republikën e Maqedonisë në moshë nga 15 dhe 64 vjet të cilët jetojnë në amvisëri private (N = 3.500), (në tekstin në vazhdim të prezantuar si të gjithë të rriturit). Në këtë kontigjent demografik ka pasur 1.457.092 banorë (regjistrimi i popullsisë viti 2002). Gjithashtu, në veçanti u prezantuan rezultatet për grupmoshën nga 15-34 vjet (N = 1.798), (në tekstin në vazhdim si të rinjtë më të rritur). Në këtë kontigjent demografik ka pasur 591.702 banorë (regjistrimi i popullsisë viti 2002). Rezultatet më të rëndësishme për të gjithë të rriturit janë prezantuar sipas moshës dhe gjinisë.

#### **DUHANI**

##### **Prevalenca e përdorimit aktiv të duhanit**

- Pothuajse një në dy të rritur është duhanpirës aktiv (46%).
- Tek të rinjtë më të rritur, 40,2% kanë deklaruar se janë duhanpirës aktiv.
- Përqindja e duhanpirësve aktiv është më e lartë tek grupmoshat 35-44 (57,6%), pastaj tek grupmosha 45-54 (54,4%).
- Përqindja e duhanpirësve aktiv tek meshkujt (54,1%) ishte më e madhe krahasuar me atë të femrave duhanpirëse (33,3%).

##### **Prevalenca jetësore e përdorimit të duhanit**

- Më shumë se gjysma e të gjithë të rriturve kanë deklaruar se në ndonjë fazë të jetës së tyre kanë pirë duhan (55,4%).
- Prevalenca jetësore e përdorimit të duhanit tek të rinjtë më të rritur është 50,7%.
- Prevalencë më e lartë të përdorimit të duhanit është regjistruar tek grupmosha nga 35-44 vjet (62,6%).
- Prevalenca jetësore e përdorimit të duhanit është shumë më e lartë tek meshkujt (63,2%) se sa tek femrat (43,1%).

#### **ALKOOLI**

## **Prevalenca e përdorimit të alkoolit**

- Shumica e të gjithë të rriturve kanë deklaruar se në një periudhë të jetës së tyre kanë konsumuar alkool (86,4%). Gjithashtu, 59,2% e të gjithë të rriturve kanë deklaruar se kanë konsumuar alkool gjatë vitit të kaluar, si dhe gjatë 30 ditëve të fundit.
- Prevalenca jetësore e konsumimit të alkoolit tek të rinjtë më të rritur është 76%. Në po atë grupmoshë vitin e kaluar dhe muajin e kaluar shkalla e prevalencës së konsumimit të alkoolit ka qenë 67,8%.
- Konsumimi më i lartë i alkoolit është konstatuar tek grupmosha 25-34 (76,9%), pastaj 74,7% tek grupmosha 15-24. Prevalencë më të lartë të përdorimit të alkoolit në vitin e kaluar dhe muajin e kaluar ka tek grupmosha 15-24 (68,5%).
- Prevalenca e përdorimit të alkoolit ka qenë më e lartë tek meshkujt se sa tek femrat—prevalenca ka qenë 70,4% tek meshkujt dhe 56,6% tek femrat. Po kjo prevalencë e konsumimit të alkoolit mes meshkujve dhe femrave është konstatuar edhe për vitin e kaluar dhe për muajin e kaluar - 64,8% dhe 50,5%,.

## **Frekuenca e konsumimit të alkoolit**

- Të gjithë të rriturit 42,9% kanë deklaruar se konsumojnë alkool një herë në muaj ose më pak. Alkooli konsumohet 2 deri në 4 herë në muaj nga 30,3% e të gjithë të rriturve, 2 deri më 3 herë në javë alkool përdorin 16,1% e të gjithë të rriturve dhe 4 katër ose më shumë herë në javë 8,9% e të gjithë të rriturve.
- 46% e të rinjve më të rritur kanë deklaruar se konsumojnë alkool një herë në muaj ose më pak se një herë. Alkool konsumohet 2 deri më 4 herë në muaj nga 32,3% e të rinjve, 2 deri në 3 herë në javë nga 14,1% e të rinjve, dhe 4 katër ose më shumë herë në javë nga 5,8% e të rinjve.
- 4 katër ose më shumë herë në javë alkool kanë konsumuar tek grupmosha 55-64 (16,9%).
- Pothuajse katër herë më shumë meshkuj se sa femra kanë deklaruar se konsumojnë alkool 4 katër ose më shumë herë në javë (11,7% dhe 3,4%, përkatësisht).

## **Llojet e alkoolit që përdoren më së shumti**

- Tek të gjithë të rriturit, 35,4% zakonisht konsumojnë birrë, 30,9% konsumojnë verë dhe 16,6% konsumojnë pije të forta alkoolike. Vetëm 8,3% e të anketuarve kanë deklaruar se konsumojnë ndonjë pije tjetër alkoolike nga këto tre pije të përmendura.
- Në mesin e të rinjve më të rritur, 36% kanë deklaruar se konsumojnë birrë. Verën e konsumojnë 33,6% e të anketuarve në këtë grup, ndërsa pijet e tjera konsumohen nga 12,8% e të anketuarve. Pijet e forta alkoolike i kanë përdorur vetëm 8,2% e të rinjve.

- Tek të gjitha grupmoshat pija e preferuar është birra krahasuar me pijet e tjera alkoolike më pak të preferuara. Birra është pija më e përzgjedhur grupmosha 15-24 vjet (39,7%), vera tek grupmosha 25-34 vjet (35,2%), pijet e forta alkoolike tek grupmosha 55-64 vjet (39,6%) dhe pijet e tjera alkoolike tek grupmosha 15-24 vjet (13,2%).
- Pothuajse dy herë më shumë meshkuj se sa femra e kanë deklaruar verën si pijen alkoolike të cilën do e kishin zgjedhur (40,8% dhe 24,8%, përkatësisht), ndërsa pothuajse dy herë më shumë femra se sa meshkuj kanë deklaruar se do kishin zgjedhur verë (43,8% dhe 24,2%, përkatësisht).

### **Frekuenca e konsumimit të alkoolit madje edhe në sasi të vogla gjatë 12 muajve të fundit**

- Tek të gjithë të rriturit, shumica e të anketuarve ose 27,8% kanë deklaruar se konsumojnë alkool dy deri tre ditë në muaj, ndërsa 15% kanë deklaruar se konsumojnë alkool 1 ditë në muaj. Një përqindje e vogël e të rinjve në moshë nga 15 dhe 64 vjet kanë deklaruar se konsumojnë alkool 1 ditë në vit. Rreth 3,3% e të anketuarve në këtë grup konsumojnë alkool çdo ditë dhe 2,9% 5-6 ditë në javë.
- Shumica e të rinjve, ose 27,4% kanë deklaruar se kanë konsumuar alkool 2-3 ditë në muaj, pastaj 16,4% që kanë deklaruar se kanë konsumuar alkool 1 ditë në muaj dhe 16% që kanë konsumuar 1-2 ditë në javë. Përqindja e të anketuarve që kanë deklaruar se kanë konsumuar alkool 1 ditë në vit ka qenë shumë e vogël (2%).
- Tek të gjitha grupmoshat, pjesa më e madhe e të anketuarve kanë deklaruar se konsumojnë alkool 2-3 ditë në muaj. Përdorimi i përditshëm i alkoolit është më dominant tek grupmosha 55-64 (5,9%) pastaj vjen grupmosha nga 45-54 (3,3%) dhe 35-44 vjet (2,9%).
- Shumica e meshkujve dhe femrave kanë pirë alkool 2-3 ditë në muaj (28,8% përkundër 26,1%). Konsumim të përditshëm të alkoolit kanë deklaruar 4% meshkuj dhe 1,8% femra, si dhe 5-6 ditë në javë kanë deklaruar 4% meshkuj dhe 0,8% femra.

### **Frekuenca e konsumimit të gjashtë ose më shumë gota me pije alkoolike në një rast të vetëm**

- Gjashtë ose më shumë gota me pije alkoolike në një rast të vetëm një herë në muaj (dehje) kanë konsumuar 6,7% e të gjithë të rriturve, 1-2 ditë në javë 3,6%, ndërsa për çdo ditë ose së paku 3 herë në javë 4,7% e të gjithë të rriturve. Pothuajse ¼ e të gjithë të rriturve (25%) kanë deklaruar konsumim të tepërt (dehje) të pijeve alkoolike shumë më rrallë se një herë në muaj.
- Gjashtë ose më shumë gota me pije alkoolike në një rast të vetëm (dehje) një herë në muaj kanë konsumuar 8,7% e të rinjve më të rritur, 1-2 ditë në javë 4,4%, ndërsa konsumim

të përditshëm ose së paku 3 herë në javë 5,1% e të rinjve. Pak më shumë se ¼ e të rinjve (27,6%) kanë konsumuar alkool shumë më pak se një herë në muaj.

- Konsumim i përditshëm i sasive më të mëdha të alkoolit është raportuar tek grupmosha 15-24 (1,7%), pastaj tek grupmosha 55-64 vjet (1,5%). Rreth 1% e të anketuarve tek të gjitha grupmoshat kanë deklaruar konsumim të përditshëm të më shumë pijeve alkoolike me një përfaqësim më të ulët tek grupmosha 35-44 (0,1%). Në grupmoshën nga 25-34 vjet, përqindja e atyre që kanë deklaruar konsumim të sasive të mëdha të alkoolit një herë në muaj (8,1%) ka qenë më e lartë, pas tyre vjen grupi i cili ka deklaruar konsumim të sasive të mëdha të alkoolit 1-2 ditë në javë (4,5%). Tek grupmosha 15-24 vjet, përqindja e atyre që kanë deklaruar konsumim të sasive të mëdha të alkoolit, më pak se një herë në muaj (29,3%) është më e lartë.

- Konsumim të sasive të mëdha të alkoolit një herë në muaj bëjnë 27,3% tek meshkujt dhe 20,3% tek femrat. Meshkuj kanë deklaruar që dehen më shpesh se femrat. Dy herë më shumë meshkuj (5,9%) se femrat (2,3%) kanë deklaruar konsumim të sasive të mëdha të alkoolit për çdo ditë, ose së paku 3 ditë në javë.

### **Numri i pijeve alkoolike të konsumuara në një rast të vetëm**

- Pjesa më e madhe e të anketuarve (53,1%) tek të gjithë të rriturit kanë deklaruar se konsumojnë 1-3 pije alkoolike në një rast të vetëm, pastaj 25,3% të cilët kanë deklaruar se kanë konsumuar 4-6 pije alkoolike. Konsumim të 16-20 pijeve alkoolike në një rast të vetëm kanë deklaruar 0,5% e të anketuarve, pastaj 0,8% prej tyre kanë deklaruar se kanë konsumuar edhe më shumë se 20 pije alkoolike.

- Te grupmosha 15-34 rreth 13,1% kanë deklaruar se kanë konsumuar 7-10 pije alkoolike në një rast të vetëm. Konsumim të më shumë se 11 pijeve alkoolike në një rast të vetëm kanë deklaruar vetëm 5,6% e të anketuarve.

- Shumica e përfaqësuesve tek të gjitha grupmoshat kanë deklaruar se kanë konsumuar 1-3 pije alkoolike në një rast të vetëm dhe atë me përqindje më të madhe tek grupmosha 45-54 vjet (69,1%), pastaj vjen grupmosha nga 55-64 vjet (62,2%). Grupmosha 35-44 vjet kishte përqindje më të lartë të të anketuarve (12%) të cilët deklaruan konsumim të më shumë se 11 pijeve alkoolike në një rast të vetëm, dhe në fund grupmosha 15-24 vjet me 6,8% dhe grupmosha 25-34 me 4,8%.

- Përqindje e ngjashme e meshkujve dhe femrave kanë deklaruar se konsumojnë 6-10 pije alkoolike (9,7% përkundër 7,8%) dhe 11-15 pije alkoolike (2,3% meshkuj dhe 2,2% femra) në një rast të vetëm. Konsumim të më shumë se 15 pije alkoolike në një rast të vetëm kanë deklaruar 1,5% e meshkujve dhe 1% e femrave.

### **BARNAT**

### **Prevalenca e përdorimit të sedativëve dhe / ose qetësuesve (barnave për qetësim) gjatë vitit të kaluar**

- Gjatë vitit para realizimit të hulumtimit 32,5% e të gjithë të rriturve kanë përdorur sedativë dhe / ose barna për qetësim së paku një herë.
- Vitin e kaluar, prevalenca e përdorimit të sedativëve dhe / ose barnave për qetësim tek të rriturit ka qenë 23,2%.
- Prevalencë më të lartë të përdorimit të sedativëve dhe / ose barnave për qetësim gjatë vitit kishte tek grupmosha nga 55-64 vjet (52,3%).
- Vitin e kaluar prevalenca e përdorimit të sedativëve dhe / ose barnave për qetësim ka qenë më e lartë tek femrat (39,3%) se sa tek meshkujt (28,1%).

### **Prevalenca e përdorimit të sedativëve dhe / ose barnave për qetësim gjatë muajit të kaluar**

- Gjatë muajit para realizimit të hulumtimit, 24,1% e të gjithë të rriturve kanë përdorur sedativë dhe / ose barna për qetësim së paku një herë.
- Prevalenca mesatare e konsumimit të sedativëve dhe /ose barnave për qetësim tek të rinjtë ka qenë 14%.
- Prevalencë më të lartë të përdorimit të sedativëve dhe / ose barnave për qetësim gjatë muajit të kaluar kishte tek grupmosha nga 55-64 vjet (47,6%).
- Prevalenca mesatare e konsumimit të sedativëve dhe /ose barnave për qetësim ka qenë për 1/3 më e lartë tek femrat (31,4%) se sa tek meshkujt (19,5%).

### **Frekuenca e përdorimit të sedativëve dhe / ose barnave për qetësim gjatë muajit të kaluar**

- Rreth 38,7% e të gjithë të rriturve dhe 60,6% e të rinjve më të rritur kanë deklaruar se kanë përdorur sedativë dhe / ose barna për qetësim një herë gjatë muajit të kaluar. Përqindja e përdorimit të sedativëve dhe / ose barnave për qetësim 4 herë në javë gjatë muajit të kaluar tek grupmosha 15-64 është për tre herë më e lartë krahasuar me grupmoshën nga 15-34 (20,1% përkundër 7,5%)
- Grupmosha 55-64 është konsument kryesor i sedativëve dhe / ose barnave për qetësim, rreth 38,5% i përdorin ato 4 herë në javë. 9,5% e të anketuarve në moshë nga 15-24 vjet kanë deklaruar se i përdorin sedativët dhe/ose barnat për qetësim 4 herë në javë.
- Përdorimi i sedativëve dhe / ose barnave për qetësim gjatë muajit të kaluar ka qenë më i madh tek femrat se sa tek meshkujt. Më saktësisht, 21,9% nga femrat dhe 19% nga meshkujt kanë deklaruar se kanë përdorur sedativë dhe / ose barna për qetësim 4 herë në javë gjatë muajit të kaluar.

- 17,9% e përfaqësuesve në moshë nga 55-64 vjet kanë përdorur sedativë dhe / ose barna për qetësim 20 ose më shumë ditë gjatë muajve të fundit, që është për tre herë më shumë se përfaqësuesit e grupmoshës nga 45-54 vjet (6,1%) dhe shtatë herë më shumë se përfaqësuesit e grupmoshës nga 35-44 vjet.

- Femrat e të gjithë grupeve të të rriturve krahasuar me meshkujt përdorin sedativë dhe /ose barna për qetësim më shumë ditë në javë.

### **Burimet e sigurimit të sedativëve dhe / ose barnave për qetësim herën e fundit që janë përdorur**

- Sa i përket problemit me përdorimin e sedativëve dhe / ose barnave për qetësim, është me rëndësi të theksohet se 69,2% e të gjithë të rriturve dhe 53,6% e të rinjve më të rritur kanë deklaruar herën e fundit kur kanë përdorur sedativë dhe / ose barna për qetësim ato i kanë marrë me rekomandim nga mjeku. Përdorimi i sedativëve dhe / ose barnave për qetësim me rekomandim nga mjeku me kalimin e moshës rritet.

### **Shkaqet për përdorimin e sedativëve dhe / ose barnave për qetësim**

- Me përjashtim të grupmoshës nga 55-64 vjet ku sedativët dhe / ose barnat për qetësim kryesisht janë përdorur për trajtimin e sëmundjeve (44,8%), shumica e përfaqësuesve të të gjitha grupmoshave kanë deklaruar se për tu relaksuar kanë nevojë për sedativë (25,1 % tek grupmosha nga 45-55 vjet, 31,6% tek grupmosha nga 15-24 vjet, 31,9% tek grupmosha 25-34vjet dhe 34,7% tek grupmosha 35-44 vjet).

## **DROGAT E NDALUARA**

### **Prevalenca e përdorimit të drogave të ndaluara**

- Të gjithë të rriturit, 8,9% kanë deklaruar se gjatë jetës së tyre ndonjëherë kanë marrë nga drogat e ndaluara. Nga ato më e përdorur ka qenë marihuana, ndërsa 8,2% e të gjithë të rriturve kanë deklaruar se në një moment të caktuar të jetës kanë konsumuar nga kjo drogë. Prevalenca jetësore për marrjen e llojeve të tjera të ndaluara ka qenë dukshëm më e vogël: ekstazi 1,6%, amfetamina 1,1%, heroinë 1,1%, LSD 0,5% dhe kokainë 1,3%.

- 16,1% e të rinjve më të rritur kanë deklaruar se gjatë jetës së tyre ndonjëherë kanë përdorur ndonjëherë nga drogat e ndaluara. 15% e përfaqësuesve të kësaj grupmoshe kanë deklaruar se në një moment të caktuar në jetën e tyre kanë konsumuar marihuanë, ndërsa sa i përket drogave të tjera të ndaluara prevalenca jetësore është: ekstazi 2,8%, heroinë 1,7%, amfetamina 2,1%, kokainë 2,5 % dhe LSD 1%.

- Prevalencë më të lartë gjatë jetës për përdorimin e cilit do lloj nga drogat e ndaluara ka në mesin e grupmoshës nga 15-24 vjet (18,9%), me një rënie proporcionale me kalimin e moshës.

- Pak më shumë meshkuj se ferma nga të gjithë të rriturit kanë deklaruar se së paku një herë në jetën e tyre kanë përdorur ndonjë nga drogat e ndaluara (10,3% dhe 6,7%, përkatësisht). Përdorimi i marihuanës gjatë jetëzgjatjes gjithashtu dallonte sipas gjinisë, me ç'rast dominojnë meshkujt (9,9%) për dallim nga femrat (5,6%).

Ekstazi kanë përdorur 1,7% e meshkujve dhe 1,4% e femrave, amfetamina kanë përdorur 1,3% meshkuj dhe 0,8% nga femrat, kokainë kanë përdorur 1,7% e meshkujve dhe 0,7% nga femrat, heroinë kanë përdorur 1,6% meshkuj dhe 0,4% femra, ndërsa LSD ka prevalencën më të ulët jetësore gjatë jetës – atë e kanë përdorur 0,6% meshkuj dhe 0,6% femra.

### **Prevalenca e përdorimit të drogave të ndaluara gjatë vitit të kaluar**

- Tek të gjithë të rriturit, 6,9% kanë deklaruar se kanë përdorur ndonjë nga llojet e drogave të ndaluara së paku një herë gjatë vitit para realizimit të hulumtimit. Marihuana është droga më e përdorur, 6,6% e të gjithë të rriturve kanë deklaruar se e kanë përdorur gjatë vitit të kaluar. Prevalenca për vitin e kaluar për përdorimin e cilit do lloj të drogave të ndaluara, përveç marihuanës, është: ekstazi 0,8%, amfetamina 0,6%, kokainë 0,9%, heroinë 0,8% dhe LSD 0,3%.

- 12,6% e të rinjve më të rritur kanë deklaruar se kanë përdorur ndonjë nga llojet e drogave të ndaluara së paku një herë gjatë vitit të kaluar. Më shumë se një në dhjetë të rinj më të rritur kanë deklaruar se kanë përdorur marihuanë së paku një herë gjatë vitit të kaluar (12,5%). Prevalenca për vitin e kaluar për përdorimin e cilit do lloj tjetër prej drogave të ndaluara, përveç marihuanës, ka qenë dukshëm më e vogël: ekstazi 1,6%, amfetamina 1,3%, kokainë 1,8%, heroinë 1,5% dhe LSD 0,5%.

- Shkalla më e lartë e prevalencës në vitin e kaluar për përdorimin e cilit do lloj prej drogave të ndaluara ishte në mesin e përfaqësuesve të grupmoshës nga 15-24 vjet (15,4%).

- Prevalenca për vitin e kaluar për përdorimin e cilit do lloj prej drogave të ndaluara tek të anketuarit në moshë nga 15 dhe 64 vjet ishte pak më e lartë tek meshkujt, krahasuar me femrat (8,5% dhe 4,4%). Prevalenca mesatare e përdorimit të drogave të veçanta tek të anketuarit në moshë nga 15 dhe 64 vjet ishte më e lartë tek meshkujt se sa tek femrat. Shkalla mesatare e prevalencës së përdorimit të marihuanës tek meshkujt ishte 8,3%, ndërsa tek femrat 4%, ndërsa shkallët e prevalencës gjatë vitit të kaluar për përdorimin e llojeve të tjera të drogave të ndaluara ishin mjaft të ulëta, por megjithatë silleshin nga 1-2%, përveç se për amfetaminat dhe LSD që ishin nën 1%.

### **Prevalenca e përdorimit të drogave të ndaluara gjatë muajit të kaluar**

- Gjatë muajit para hulumtimit, 4,3% e të gjithë të rriturve kanë deklaruar se kanë përdorur ndonjë lloj të drogave të ndaluara. Droga më e përdorur ka qenë marihuana, ndërsa 4,1% e të gjithë të rriturve kanë deklaruar se e kanë përdorur këtë drogë gjatë muajit të kaluar. Shkallët e prevalencës gjatë muajit të kaluar për përdorimin e llojeve të tjera të drogave të

ndaluara ishin dukshëm më të ulëta: ekstazi 0,4%, amfetamina 0,4%, heroinë 0,7%, kokainë 0,4% dhe LSD 0,2%.

- Shkalla e prevalencës gjatë muajit të kaluar për përdorimin e llojeve të tjera të drogave të ndaluara tek të rinjtë është 10,4%. Tek të rinjtë më të rritur, 8% kanë deklaruar se kanë përdorur marihuanë gjatë muajit të kaluar, ndërsa shkalla e prevalencës gjatë muajit të kaluar për përdorimin e drogave të tjera, përveç marihuanës, ka qenë: amfetamina 0,8%, heroinë 1,3%, kokainë 0,9%, LSD 0,3% dhe ekstazi 0,8%.

- Shkalla më e lartë e prevalencës gjatë muajit të kaluar për përdorimin e cilit do lloj nga drogat e ndaluara ishte në mesin a atyre në moshë nga 15-24 vjet (10,8%), ndërsa në vazhdim janë grupmoshat e tjera.

- Shkalla e prevalencës gjatë muajit të kaluar për përdorimin e cilit do lloj nga drogat e ndaluara dallon shumë mes gjinive të ndryshme (5,4% tek meshkujt dhe 2,6% tek femrat). Gjatë muajit të kaluar, shkalla e prevalencës për përdorimin e llojeve të drogave të ndaluara tek të anketuarit në moshë nga 15-64 vjet ka qenë më e lartë tek meshkujt se sa tek femrat. Rezultatet e fituara: marihuanë (5,3% meshkuj dhe 2,5% për femra); ekstazi (0,6% meshkuj dhe 0,1% femra); amfetamina (0,5% meshkuj dhe 0,2% femra); kokainë (0,7% meshkuj dhe 0,1% femra); heroinë (1% meshkuj dhe 0,2% femra); dhe LSD (0,2% meshkuj dhe 0% femra).

## **QËNDRIMET PËR PËRDORIMIN E SUBSTANCAVE PSIKOAKTIVE DHE PERCEPTIMI I RREZIQEVE SI PASOJË E PËRDORIMIT TË SUBSTANCAVE PSIKOAKTIVE**

### **Qëndrimet për përdorimin / provimin e drogave të ndaluara**

- Shumica e të gjithë të rriturve (81,8%) nuk janë dakord që njerëzit të përdorin rregullisht marihuanë ose hashash, 2,9% nuk janë kundër, ndërsa të tjerët (6,6%) janë neutral. Mospajtimi në lidhje me atë nëse duhet të lejohet pirja e rregullt e marihuanës ose hashashit me kalimin e moshës shtohet. Meshkujt, për dallim nga femrat janë më të prirur të mos jenë dakord që njerëzit të mund të përdorin rregullisht marihuanë ose hashash (79,8% dhe 84,9%, përkatësisht).

- Rreth 73,3% e të gjithë të rriturve nuk pajtohen që marihuana të mund të provohet një ose dy herë, ndërsa 76,1% nuk pajtohen që ajo të konsumohet me raste. Me kalimin e moshës kjo përqindje rritet.

Nga të gjithë të rriturit 3,6% kanë deklaruar se janë dakord që njerëzit të provojnë ekstazi një ose dy herë, ndërsa 2,6% nuk kanë kundër që të provohet një ose dy herë edhe heroina. Mospajtimi nga ana e njerëzve në lidhje me provimin e drogave të ndaluara është karakteristik për të gjitha moshat dhe për të dy gjinitë.

### **Qëndrimet për konsumimin e alkoolit**

- Shumica e të gjithë të rriturve 51,2% kanë deklaruar nuk janë dakord që njerëzit të provojnë një ose dy pije alkoolike disa herë në javë. Megjithatë, 35% e të anketuarve e miratojnë këtë sjellje. Miratimi i kësaj sjelljeje bie me kalimin e moshës.
- Meshkuj janë më pak të prirur se femrat që të miratojnë konsumimin e një ose dy pijeve alkoolike disa herë në javë (38,1% dhe 30%, përkatësisht)

### **Perceptimi i rrezikut si pasojë e pirjes së duhanit dhe konsumimit të alkoolit**

- Më shumë se gjysma e të gjithë të rriturve (56,3%) mendojnë se ekzistoj rrezik i madh nga pirja e një ose më shumë kuti me cigare në ditë. Kjo shkallë e perceptimit të rrezikut nga pirja e një ose më shumë kuti me cigare në ditë me kalimin e moshës rritet. Femrat kanë qenë më pak të prirura se meshkujt për ta vlerësuar rrezikun që sjell pirja e një ose më shumë kuti me cigare në ditë (83,2% dhe 86,4%).
- Tek të gjithë të rriturit, vetëm 6,3% e vlerësojnë si të madh rrezikun që sjell konsumimi i pesë ose më shumë pijeve alkoolike çdo fundjavë, 48,3% e konsiderojnë si rrezik mesatar dhe 23,9% si rrezik të ulët. Kjo shkallë e perceptimit të rrezikut nga konsumimi i pesë ose më shumë pijeve alkoolike çdo fundjavë me kalimin e moshës rritet. Pjesëtarët e të dy gjinive kanë perceptime shumë të ngjashme për këtë rrezik si të lartë (6,2% dhe 6,3%, përkatësisht)

### **Perceptimi i rrezikut si pasojë e përdorimit të drogave të ndaluara**

- Rreziku që vjen si pasojë e pirjes së rregullt të marihuanës u vlerësua si i lartë nga 69,2% e të gjithë të rriturve. Femrat, për dallim nga meshkujt, e vlerësuan këtë rrezik si të lartë (73,8% femra krahasuar me 66,8% meshkuj).
- Rreziku si pasojë e përdorimit të kokainës është vlerësuar si i lartë nga 75,1% e të gjithë të rriturve.
- Përqindja e perceptimit të rrezikut që buron nga përdorimi i të gjitha drogave të ndaluara me kalimin e moshës rritet.

## **QËNDRIME PËR MUNDËSINË PËR SIGURIMIN E DROGAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

### **Qasja personale në disa lloje të veçanta të drogave**

- Sipas perceptimit për qasje në marihuanë, ekstazi, amfetamina, kokainë, heroinë dhe LSD, shumica e të gjithë të rriturve kanë deklaruar se kjo gjë është e pamundur, shumë e vështirë ose e vështirë, për 55,1% për marihuanë, 63,4% për ekstazi, 66,8% për ekstazi, 69,6% për kokainë, 70% për heroinë dhe 69% për LSD. Me rritjen e moshës rritet edhe përqindja e personave të cilët mendojnë se drogat e ndaluara nuk mund të blihen lehtë. Meshkujt, për

dallim nga femrat, kanë deklaruar se ato do e kishin më të lehtë ose shumë të lehtë të sigurojnë ndonjë nga këto droga.

### **Njohja e personave të cilët përdorin droga të ndaluara**

- Sa i përket njohjes dhe kontakteve personale me persona të cilët përdorin droga të ndaluara, të gjithë të rriturit (grupmosha nga 15-64) janë deklaruar kështu: kanabis (55,8%), ekstazi (25,1%), amfetamina (15%), kokainë (8,9%), heroinë (6,2%) dhe LSD (0,8%).

### **OFERTA E DROGAVE TË NDALUARA**

#### **Frekuenca gjatë vitit të kaluar – sa herë një personi i është ofruar të blejë drogë**

- Të rriturve të cilëve u është ofruar të blejnë ndonjë lloj nga drogat e ndaluara: marihuanë (12,7%), heroinë (3,4%), kokainë (3,8%), ekstazi (4,6%), amfetamina (3,9%) dhe LSD (2,7%).
- Të rinjve të cilëve u është ofruar të blejnë ndonjë lloj nga drogat e ndaluara: marihuanë (21,1%), heroinë (6,2%), kokainë (6,8%), ekstazi (8,8%), amfetamina (7,7%) dhe LSD (5,2%).
- Sa i përket raportit për të gjithë të rriturit dhe të gjithë të rinjtë, pjesës më të madhe të tyre u është ofruar një deri në dy herë ndonjë lloj nga drogat e ndaluara, në të shumtën e rasteve nëpër shtëpi private ose nëpër vende publike.

### **SUBSTANCA TË REJA PSIKOAKTIVE**

- Prevalenca jetësore për përdorimin e substancave të reja psikoaktive mbetet e ulët (0,6%)
- Vitin e kaluar prevalenca e përdorimit të substancave të reja psikoaktive ka qenë 0,6% tek popullata në moshë nga 15 deri më 64 vjet, ndërsa 1,1% tek të rinjtë më të rritur (15-34 vjet).

### **STEROIDË ANABOLIK**

- Prevalenca jetësore e përdorimit të steroidëve anabolik tek popullata në moshë nga 15 deri më 64 vjet është 2,6%, ndërsa tek të rinjtë 3,9% dhe dominon tek të rinjtë meshkuj.
- Vitin e kaluar dhe muajin e kaluar prevalencat kanë qenë nën 1%.